VENDIM
Nr. 74, datë 12.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "NOVA SOLAR SYSTEM" SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, pika 4 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 879 prot., datë 10.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Nova Solar System' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw",

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw.

- Në vijim të këtij licencimi, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për saktësim në aneksin A të licencës së saj, për ndryshimin e numrit të njësive gjeneruese (panele) dhe vendosjen e pajisjeve të depozitimit të energjisë, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të licencës prej 50 mw.

- Për sa i përket kërkesës së shoqërisë, ERE, me *email*-in e datës 6.3.2026, i ka sqaruar shoqërisë dokumentacionin e nevojshëm për të vijuar me shqyrtimin e kësaj kërkese për disa ndryshime dhe shtesa në aneksin A të licencës.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave ("b", "d", "e", "f" dhe "g") si dhe në datën 6.3.2026, shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 15, "Modifikimi i Licencës":

Pika 4, Në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura, si për licencimin duke kërkuar informacionin e mëposhtëm.

- germa "a": aplikuesi duhet të depozitojë në ERE shtojcën 1 të plotësuar në të gjithë zërat e saj;

- germa "c": aplikuesi duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve drejtuese të saj, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës.

Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohen dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw, për ndryshimin e numrit të paneleve dhe shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "Nova Solar System" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti